

**RREGULLORE NR. 2001/26**  
**MBI TRANSAKSIONET E PAGESAVE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik të vitit 1999,

Me qëllim të rregullimit të të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësve në transaksionet e pagesave në çarëdo valute të huaj në Kosovë,

Nëpërmjet kësaj shpall sa vijon:

**Kapitla 1**  
**Dispozitat e përgjithshme**

Neni 1  
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

(a) “Llogari bankare” do të thotë çdo llogari e hapur në një bankë në bazë të një kontrate të lidhur ndërmjet një klienti dhe bankës, qoftë ajo llogari rrjedhëse, xhirrollogari ose llogari tjetër dhe përfshin një llogari sipas një marrëdhënieje të veçantë të krijuar vetëm për qëllim të realizimit të një urdhërpagese.

(b) “Mbulesë adekuate” për një urdhëresë të pagesës do të thotë ekzistimi e mjeteve të mjaftueshme, përkatësisht ekzistimi i një bilanci të llogarisë që nuk është më i vogël se shumta e urdhërpagesës, që përbëhet nga bilanci përmbyllës i ditës paraprake bankare, plus kredia që është shënuar në librin e llogarisë së iniciatorit gjatë ditës ekzistuese bankare për pagesat hyrëse, depozitat dhe shlyerjet, pagesat për të dalat më të vogla dhe shpenzimet që tani janë duke u bërë gjatë rrjedhës së asaj dite bankare, si dhe pagesat e

parashikuara bankare. Fondet të cilat pasqyrojnë thjeshtë kredinë e përkohshme të llogarisë së iniciatorit nuk përbëjnë pjesë të mbulesës adekuatë.

(c) “Marrëveshje” sa i përket kapitullit 7 do të thotë një kontratë ndërmjet një klienti dhe bankës e cila rregullon veprimet e llogarisë bankare, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e saj, modifikimin dhe urdhërpagesat.

(ç) “Verifikim ” do të thotë një vërtetim i bërë sipas një procedure të arsyeshme të sigurisë komerciale të përcaktuar me marrëveshje ndërmjet një dërguesi dhe bankës për të vërtetuar se a është lëshuar një urdhërpagesë nga personi fizik a juridik i identifikuar si dërgues. Një procedurë e arsyeshme e sigurisë komerciale mund të kërkojë shfrytëzimin e algoritmave apo kodeve të tjera, identifikimin e fjalëve ose numrave, kodifikimin, procedurat e deshifrimit ose mjete të tjera të ngjashme. Krahasimi i nënshkrimit në një urdhërpagesë apo lidhja me një nënshkrim të autorizuar të klientit nuk është vetvetiu procedurë sigurie.

(d) “Bankë” do të thotë:

- (i) një person juridik i cili merret me pranimin e depozitave dhe parave ose të fondeve të tjera të ripagueshme në përputhje me licencën bankare të lëshuar nga autoriteti kompetent përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave ose i themeluar me ligj si bankë;
- (ii) përveç bankës nga pika (a), një person juridik i autorizuar me ligj për të marrë depozita ose për të marrë pjesë në transaksionet e pagesave në llogari të klientëve dhe

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës.

(dh) “Ditë bankare” do të thotë ajo pjesë e ditës gjatë së cilës banka është e hapur për publikun për t’i kryer funksionet e saj kryesore bankare.

(e) “BPK” do të thotë Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/20 të datës 15 nëntor 1999 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës.

(ë) “Degë ose zyrë e veçantë e bankës” do të thotë një bankë e veçantë me qëllim të llogaritjes së afatit kohor ose përcaktimit të vendit kur mund të bëhet padia a njoftimi, kur mund të jepet një njoftim apo urdhër.

(f) “Likuidim” do të thotë këmbimi dhe përpunimi i urdhërpagesave ndërbankare me qëllim të llogaritjes së shumave neto bilaterale ose multilaterale që ndonjë bankë i ka borxh asaj ose ajo atyre me qëllim të shlyerjes së urdhërpagesave të përfshira në cilindo cikël të likuidimit.

(g) “Transfer i kredisë” do të thotë një transaksion i pagesës i kryer nga paguesi, i cili lëshon një urdhërpagesë për bankën e tij, duke udhëzuar atë që t’i transferojë fondet nga llogaria bankare e paguesit te i paguari ose në llogarinë bankare të tij. Në një transfer kredie, iniciatori është paguesi, banka iniciatore është banka e paguesit, banka destinuese është banka e të paguarit dhe marrësi është i paguari.

(gj) “Klient” do të thotë një person fizik a juridik, duke përfshirë edhe një bankë e cila ka të hapur një llogari bankare në një bankë tjetër.

(h) “Transfer debitit” do të thotë një transaksion i pagesës i inicuar nga urdhërpagesa e të paguarit, sipas autorizimit të paguesit, me të cilën urdhërohet banka e paguesit për t’i tërhequr paratë nga llogaria e paguesit. Në një transfer debiti, iniciatori është i paguari, banka iniciatore është banka e të paguarit, banka destinuese është banka e paguesit dhe marrësi është paguesi.

(i) “Bankë destinuese” do të thotë banka e identifikuar në udhërpagesën në të cilën i bëhet pagesa të paguarit në një transfer të kredisë, ose mbahet llogaria e një paguesi në një transfer debiti.

(j) “Elektronikisht” do të thotë me anë të telekomunikimit me interneti ose me dërgimin fizik të shiritave, disketave apo mjeteve të ngjashme;

(k) “Ekzekutim” do të thotë zbatimi i instruksioneve të përfshira në një udhërpagesë duke i lëshuar një urdhërpages korresponduese bankës marrëse.

(l) “Valutë e huaj” do të thotë çfarëdo valute tjetër përveç dinarit jugosllav.

(ll) “Fonde” do të thotë para të gatshme dhe depozita që mbahen në llogari bankare.

(m) “Transfer i brendshëm” do të thotë transfer i fondeve, nga paguesi te i paguari në të njëjtën bankë, përmes një urdhërpagese. Pjesëmarrës në një transfer të brendshëm janë iniciatori, banka e cila vepron si bankë iniciatore apo destinuese dhe marrësi.

(n) “Transfer ndërbankar” do të thotë transfer i fondeve nga paguesi te i paguari në dy banka të veçanta që kanë, së paku dy urdhërpagesa për secilën bankë marrëse përveç bankës destinuese që kryen udhërpagesën e dërguesit të saj, duke i lëshuar urdhërpagesë përkatëse bankës marrëse, me urdhërpagesën e fundit që i është dërguar bankës destinuese. Pjesëmarrës në një transfer ndërbankar janë iniciatori, banka iniciatore, banka destinuese dhe marrësi dhe mund të përfshijë një ose më shumë banka ndërmjetësuese. Në një transfer ndërbankar, përveç veprimit në emër të klientit, banka mund të veprojë në emër dhe për llogari të saj.

(nj) “Bankë ndërmjetësuese” do të thotë bankë marrëse, përveç bankës iniciatore ose bankës destinuese.

(o) “Person juridik” do të thotë një ndërmarrje ose një institucion publik.

(p) “Bankë iniciatore” do të thotë banka e cila pranon urdhërpagesën e parë që inicon një transaksion pagese.

(q) “Iniciator” do të thotë dërguesi i urdhërpagesës së parë që inicon një transaksion të pagesës.

(r) “Llogari kursimi” do të thotë një llogari sipas së cilës banka ia regjistron të hyrat dhe të dalat klientit, duke i shënuar ato në një librezë kursimi që banka ia jep klientit dhe të cilën klienti ia prezanton bankës me rastin e regjistrimeve të tilla.

(rr) “I paguari” do të thotë pala që duhet të pranojë pagesën në një transaksion pagese.

(s) “Urdhërpaguesë” do të thotë një urdhër i pakusht i dërguesit, me përjashtim të një kambiali ose një çeku, por që përfshin një urdhër për marrjen e një kambialeve apo të një çeku, që i është dhënë një banke marrëse për të paguar ose për të marrë një shumë specifike të parave nga një llogari e caktuar bankare, nga i paguari ose për të paguarin, apo për llogarinë a nga llogaria e të paguarit. Kur dërguesi është një bankë, urdhërpaguesa është urdhërpaguesë ndërbankare.

(sh) “Transaksion i pagesës” do të thotë transfer i fondeve nga llogaria bankare e paguesit te i paguari ose llogaria bankare e të paguarit. Paguesi dhe i paguari mund të jenë persona të njëjtë ose dy persona të ndryshëm fizikë a juridikë. Transaksioni i pagesës mund të jetë një kredi ose një transfer debetit i fondeve dhe inicohet me udhërpaguesën e iniciatorit që i është dhënë bankës iniciatore, duke urdhëruar atë që ta kryejë transaksionin e pagesës. Në një transaksion pagese, llogaria bankare e paguesit mund të mbahet dhe pagesa mund t’i bëhet të paguarit qoftë në të njëjtën bankë qoftë në dy banka të ndryshme.

(t) “Pagues” do të thotë pala e cila duhet të bëjë pagesën në një transaksion pagese.

(th) “Marrës” do të thotë personi fizik dhe a juridik, banka e cila duhet ta marrë urdhërpaguesën e fundit në një transaksion pagese.

(u) “Bankë marrëse” do të thotë banka të cilës i adresohet urdhërpaguesa e dërguesit.

(v) “Dërgues” do të thotë personi fizik a juridik që i jep një udhërpaguesë një banke marrëse.

(x) “Shlyerje” do të thotë pagesa për shlyerjen e një detyrimi në një pagesë ndërbankare.

(xh) “Llogari e shlyerjes” do të thotë llogaria bankare që një bankë e mban në librat e BPK-së për kryerjen e transaksioneve të pagesave hyrëse dhe dalëse.

(y) “Datë e vlefshme ” do të thotë dita bankare në të cilën një urdhër i pagesës duhet të kryhet sipas udhëzimeve të dërguesit.

## Neni 2

### Llogaritë bankare në valutë të huaj

Personat fizikë dhe juridikë mund të hapin llogari bankare në çfarëdo valute të huaj dhe t’i kryejnë transaksionet e pagesave përmes këtyre llogarive bankare në përputhje me ligjin në fuqi. Një person fizik a juridik mund të ketë më shumë se një llogari rrjedhëse dhe atë në më shumë se një bankë.

## Neni 3

### Transaksionet e pagesave

3.1 Në një transaksion pagese, banka mund të veprojë në emër të klientit ose të bankës korrespondente me seli jashtë Kosovës.

3.2 Një transaksion pagese mund të jetë jashtë ose brenda një llogarie bankare në BPK, me ç'rast kjo Rregullore vlen për BPK-në si bankë.

## **Kapitla 2** **Urdhërpagesa**

### Neni 4 Urdhërpagesa

4.1 Urdhërpagesa mund të jepet me shkrim, në mënyrë elektronike ose me gojë nëse për këtë më parë është dhënë përlqim a pajtim me shkrim ndërmjet palëve për këtë urdhërpagesë. Nëse është arritur një pajtim i tillë paraprak, urdhërpagesat e mëvonshme ose urdhëresat e anuluar mund të jepen me gojë.

4.2 Një urdhërpagesë duhet në mënyrë të saktë të identifikojë marrësin dhe bankën destinuese. Kur urdhërpagesa identifikon palën e urdhërpagesës me emër dhe me numër, banka marrëse mund ta zbatojë urdhërpagesën e tillë duke u mbështetur qoftë në emër, qoftë në numër. Nëse banka marrëse konstaton mospërputhshmëri midis emrit dhe numrit, ajo e refuzon urdhërpagesën.

4.3 Një urdhërpagesë mund të dërgohet ose të pranohet nga një bankë me seli brenda ose jashtë Kosovës.

4.4 Pavarësisht se a dërgohet nga brenda ose jashtë Kosovës, urdhërpagesa e pranuar nga dega apo zyra e veçantë e bankës me seli në Kosovë, rregullohet me këtë Rregullore dhe me ligjet tjera në fuqi në Kosovë.

4.5 Një urdhërpagesë e pranuar nga dega ose nga zyra e veçantë e bankës me seli jashtë Kosovës rregullohet me ligjin e vendit në fuqi ku ajo degë ose zyrë e veçantë ndodhet.

4.6 Banka iniciatore në një transfer kredie dhe një bankë destinuese në një transfer debiti, që ka pranuar gjatë një dite bankare më shumë se një urdhërpagesë ose urdhëresa të tjera të ligjshme, mund t'i përpunojë në çfarëdo radhe, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me ligjin në fuqi.

4.7 Banka duhet rregullisht të ketë kujdes në marrjen, procesin dhe transferin e urdhërpagesave. Pas interpretimit të kujdesshëm e të drejtë të urdhërpagesave të dyshimta, dhe duke vepruar në mirëbesim e pa dijeni se është duke vepruar në kundërshtim me kërkesën e vërtetë të dërguesit, banka mund t'i zbatojë urdhërpagesat sipas kuptimit të arsyeshëm të tyre.

4.8 Klienti duhet rregullisht të ketë kujdes që të parandalojë falsifikimin dhe lëshimin e paautorizuar ose të ndryshuar të urdhërpagesave me qëllim që të sigurohet kuptueshmëria dhe qartësia e urdhërpagesave.

### Neni 5 Kompetencat e marrësit në një transfer debiti

5.1 Në një transfer debiti, marrësi mund t'ia revokojë autorizimin e tij iniciatorit, duke njoftuar bankën destinuese për revokimin e autorizimit me shkrim, në mënyrë elektronike ose me gojë, nëse një pëlqim i tillë me shkrim është arritur paraprakisht para përfundimit të transaksionit të pagesës dhe në kohën e mënyrën që është e mjaftueshme për t'i dhënë bankës destinuese një mundësi të arsyeshme që të veprojë lidhur me një njoftimin të tillë. Pas këtij njoftimi, banka destinuese e refuzon urdhërpagesën e dërguesit.

5.2 Në një transfer debiti, njoftimi për vdekjen e marrësit ose për marrjen e vendimit për paaftësinë juridike të tij nga banka destinuese, e ka po atë vlerë të cilën e ka edhe njoftimi i marrësit për revokimin e autorizimit sipas nenit 5.1.

5.3 Një klient,

- (a) llogaria bankare e të cilit debitohet në shumën e urdhërpagesës me të cilën kryhet një transfer debiti;
- (b) i cili i konteston autorizimet e iniciatorit dhe
- (c) i cili kundërshton debitin me shkrim brenda një afati prej shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për debitin në llogarinë e tij bankare

ka të drejtë në anulimin e debitit, përveç rastit kur bankës destinuese i është ofruar dëshmi për autorizimin të cilin klienti ia ka dhënë iniciatorit.

## Neni 6 Pranimi i detyrave të bankës

6.1 Në një transfer kredie, përveç rastit kur palët janë marrë vesh ndryshe, banka marrëse e zbaton urdhërpagesën e dërguesit nëse ka mbulesë adekuate në llogarinë bankare të dërguesit.

6.2 Në një transfer debiti, banka iniciatore e zbaton udhërpagesën e iniciatorit pasi t'i prezentohet në mënyrë të kënaqshme dëshmia lidhur me autorizimin e dhënë nga marrësi dhe pas marrjes së dëmshpërblimit për mbulimin e shumës së urdhërpagesës. Përveç rastit kur janë marrë vesh ndryshe, banka iniciatore nuk është e obliguar t'i ofrojë iniciatorit fonde e as kredi të përkohshme para përfundimit të transferit të debitit. Nëse llogaria bankare e iniciatorit kreditohet nga banka iniciatore, para përfundimit të transferit të debitit, kredia është e përkohshme dhe llogaria bankare e iniciatorit mund të debitohet në shumën e kreditit po që se transferi i debitit nuk është kryer në përputhje me nenin 12 të kësaj Rregulloreje.

6.3 Banka marrëse e zbaton udhërpagesën e cila

- (a) është plotësuar si duhet dhe e cila është autorizuar ose vërtetuar;
- (b) saktësisht e identifikon bankën destinuese dhe
- (c) saktësisht e identifikon marrësin.

6.4 Banka marrëse e cila nuk arrin të kryejë udhërpagesën e dërguesit duhet ta njoftojë menjëherë dërguesin për një veprim të tillë.

6.5 Banka marrëse e zbaton udhërpagesën gjatë ditës bankare kur ajo ka marrë udhërpagesën, ose në datën e vlefshme, varësiht nga ajo se cila prej tyre është e fundit. Banka marrëse mund të caktojë shkurtimin e kohës por jo para orës 12: 00 në mesditë, pas së cilës kohë çdo urdhërpagesë e pranuar konsiderohet si e pranuar në ditën e ardhshme bankare.

6.6 Banka marrëse duhet të veprojë me kujdes dhe vullnet të mire, t'i përmbahet standardeve bankare ndërkombëtare dhe t'i ndihmojë pjesëmarrësit në kryerjen e kënaqshme të çfarëdo urdhërpagese . Ajo duhet ta ruajë konfidencialitetin dhe të veprojë në interesin më të mirë të dërguesit.

### Neni 7

#### Anulimi dhe tërheqja e urdhërpagesës

7.1 Urdhëresa për anulim duhet saktësisht ta identifikojë udhërpagesën të cilën do ta anulojë dhe mund t'i dërgohet bankës marrëse me shkrim, në mënyrë elektronike ose me gojë, nëse paraprakisht është arritur pëlqim me shkrim. Nëse më parë nuk është arritur një pëlqim i tillë, urdhëresa e anulimit me gojë kërkon konfirmim me shkrim, i cili duhet t'i jepet bankës brenda 24 orësh.

7.2 Një urdhërpagesë anulohet kur një urdhëresë anulimi, e autorizuar ose e vërtetuar nga dërguesi ose në emër të tij, pranohet nga banka marrëse në kohën dhe mënyrën e cila mundëson inicimin e anulimit të një urdhërpagese para se të kryhet urdhërpagesa origjinale e dërguesit.

7.3 Pas zbatimit të urdhërpagesës së dërguesit, banka marrëse – ekzekutuese, me kërkesën e dërguesit mund t'ia lëshojë bankës së tij marrëse urdhërin për anulim në përputhje me nenin 7.2. Urdhri për anulim që i lëshohet bankës destinuese nga dërguesi i saj është i vlefshëm vetëm nëse pranohet nga banka destinuese para se të kryhet transaksioni i pagesës.

7.4 Një urdhërpagesë që nuk është zbatuar nga banka marrëse tërhiqet:

- (a) me përfundimin e ditës së pestë bankare pas pranimit ose datës së vlefshme , varësiht nga ajo se cila prej tyre është e fundit;
- (b) kur banka marrëse njoftohet për vdekjen ose për vendimin e paaftësisë juridike të dërguesit dhe
- (c) kur banka marrëse mbyllet nga organet kompetente.

7.5 Kurrfarë anulimi ose tërheqje e urdhërpagesës nuk vlen pas përfundimit të transaksionit të pagesës.

### Neni 8

#### Shlyerja ndërbankare

8.1 Shlyerja e urdhërpagesave ndërbankare mund të bëhet:

(a) për llogaritë bankare të shlyera në BPK në pëlqim me Rregulloren nr. 1999/20 të UNMIK-ut dhe Rregulloren nr. 2000/18 të BPK-së mbi “Shlyerjen dhe funksionimin e llogarive shlyerëse”.

(b) përmes regjistrimit të një debiti a kredie në një llogari, përveç llogarisë shlyerëse që një bankë e ka në një bankë tjetër ose në një bankë të tretë. Një debit ose kredi e tillë mund të jetë për një urdhërpagesë ose për disa urdhërpagesa dhe mund të bëhet në fund të ciklit shlyerës dhe

(c) me çfarëdo mjete të tjera me të cilat një detyrim përmbushet.

8.2 Shlyerja sipas nenit 8.1 bëhet:

(a) sipas nenit 8.1(a) kur shlyerja ka përfunduar në pëputhje me Rregullën nr. 2000/18 të BPK-së.

(b) sipas nenit 8.1 (b) me anë të debitit në një llogari kur debiti regjistrohet në llogari;

(c) sipas nenit 8.1 (b) me anë të kredisë në një llogari kur kredia e regjistruar në një llogari është shfrytëzuar, dhe nëse nuk është shfrytëzuar, në fillimin e ditës së ardhshme bankare pas ditës kur kredia është në dispozicion për shfrytëzim dhe banka, llogaria e së cilës ka qenë kredituar njoftohet për këtë fakt dhe

(ç) sipas nenit 8.1 (c), siç është përcaktuar me ligjin në fuqi, i cili përcakton se kur një detyrim konisderohet i përmbushur.

8.3 Pavarësisht nga neni 8.2, ku shlyerja sipas nenit 8.1(b) është për shumat neto bilaterale ose multilaterale të urdhërpagesave, shlyerja ndodh kur shlyerja bëhet në përputhje me një marrëveshje ose sipas rregullave në fuqi mbi likudimin dhe shlyerjen ndërbankare, përveç atyre në BPK.

### **Kaptina 3** **Kryerja e transferit të kredisë dhe shkarkimi**

#### Neni 9

#### Kryerja e transferit të kredisë

9.1 Transferi ëdhtë i kryer kur të paguhet banka destinuese. Në një transfer të brendshëm të kredisë, banka destinuese është paguar kur debiton llogarinë e iniciatorit në vlerën e shumës së urdhërpagesës. Në një transfer ndërbankar të kredisë, banka destinuese është e paguar kur kryhet shlyerja ndërbankare e cila përfshinë udhërpagesën e bankës dërguese.

9.2 Kur marrësi nuk ka ndonjë llogari bankare më parë në bankën destinuese ose kur një llogari e tillë bankare është mbyllur apo bllokuar për pagesat hyrëse, transferi i kredisë është i kryer kur paguhet marrësi nga ana e bankës destinuese.

#### Neni 10

#### Pagesa për marrësin



10.1 Pas kryerjes së transferit të kredisë, banka destinuese i ka borxh marrësit shumë e urdhërpagesës që ka marrë dhe duhet ta paguajë marrësin menjëherë.

10.2 Banka destinuese ia bën pagesën marrësit përmes kreditimit të llogarisë së tij jo më vonë se në ditën bankare pas kryerjes së transferit të kredisë. Kur një llogari e tillë bankare nuk ekziston ose nuk mund të identifikohet me saktësi ose kur udhëzimi është i tillë, banka destinuese duhet menjëherë ta njoftojë marrësin për disponueshmërinë e fondeve dhe e paguan marrësin sipas udhëzimit.

10.3 Kur marrësi ose llogaria bankare e marrësit nuk mund të identifikohet me saktësi në udhërpagesën të cilën e ka pranuar banka destinuese, banka destinuese e refuzon udhërpagesën dhe e njofton dërguesin lidhur me atë refuzim.

10.4 Në rastin kur banka destinuese e ka paguar marrësin ose kur e ka marrë përsipër ta paguajë atë, një pagesë ose një zotim i tillë është përfundimtar dhe i parevokueshëm dhe transferi i kredisë konsiderohet si i përfunduar, përveç rastit kur dërguesi i saj mund t'i ketë borxh ndonjë banke marrëse. Zotimi i bankës destinuese për pagim mund t'i jepet drejtëpërdrejt marrësit ose mund të bëhet me një marrëveshjeje ndërbankare.

#### Neni 11

#### Pagesa e debitit të paguar me transferin e kredisë

Kur një transfer i kredisë është paguar për pagesën e një borxhi që ka pasur iniciatori ndaj marrësit dhe që kap shumë e atij borxhi, borxhi paguhet pas kryerjes së transaksionit të pagesës.

### **Kapitla 4**

#### **Kryerja e transferit të debitit dhe shlyerja e borxhit**

#### Neni 12

#### Kryerja e transferit të një debiti

12.1 Transferi i një debitit është i kryer kur banka destinuese ka debituar llogarinë e marrësit sipas udhëzimit të udhërpagesës që e ka marrë dhe nuk e ka shlyer borxhin e nuk e ka anuluar udhërpagesën deri në mbylljen e ditës bankare pas marrjes, ose brenda cilësdo kohë për anulimin e këtij debiti në përputhje me ligjin në fuqi. Në rastin kur një urdhërpagesë i urdhëron bankës destinuese që të debitojë një llogari të identifikueshme, transferi i debitit konsiderohet i kryer me përfundimin e ditës bankare që pason pas marrjes së urdhërpagesës, madje edhe para se debiti të jetë regjistruar në llogarinë e marrësit, me kusht që urdhërpagesa të mos jetë refuzuar në mënyrë adekuate deri në atë kohë.

12.2 Deri në mbylljen e ditës bankare, pas pranimit të urdhërpagesës, banka destinuese mund ta anulojë udhërpagesën dhe ka të drejtë t'ia shlyejë shumë e paguar atij dërguesi, duke e njoftuar dërguesin e saj dhe bankën iniciatore, po qe se këto janë dy banka të veçanta, për refuzimin e saj.

12.3 Pas njoftimit për refuzim, secili dërgues bankar, përveç bankës iniciatore, ka detyrim përkatës që ta njoftojë dërguesin e saj dhe ka të drejtë që ta realizojë shlyerjen nga ai dërgues.

Secili dërgues bankar, përveç bankës iniciatore, duhet ta njoftojë dërguesin e saj lidhur me refuzimin jo më vonë se gjatë ditës bankare, pas ditës së marrjes së njoftimit për atë refuzim.

12.4 Pas njoftimit për refuzim, banka iniciatore duhet menjëherë, e jo më vonë se ditën e ardhshme bankare, ta njoftojë iniciatorin lidhur me refuzimin dhe mund të anulojë çfarëdo kredie të përkohshme, e cila më parë është regjistruar në llogarinë e iniciatorit ose, përndryshe, të mbulojë nga iniciatori çdo pagesë të bërë më parë për atë udhëpagesë.

12.5 Pavarësisht nga neni 12.2, kur banka destinuese refuzon urdhërpagesën, banka destinuese është përgjegjëse ndaj marrësit për pranimin e gabueshëm të urdhërpagesës kur:

- (a) banka destinuese ka dijeni për autorizimin e pranuesit lidhur me atë transfer të debitit;
- (b) banka destinuese ka marrë identifikim të saktë në udhëpagesë për ekzistimin e një llogarie të marrësit që mbahet në bankën destinuese dhe
- (c) ka mbulesë adekuate në atë llogari bankare.

### Neni 13 Pagesa për iniciatorin

Pas kryerjes së transferit të debitit, banka destinuese dhe çdo bankë marrëse që ka marrë pagesën nga banka e vet marrëse është përgjegjëse ndaj dërguesit në shumën e urdhërpagesës. Pagesa i bëhet dërguesit jo më vonë se në ditën e ardhshme bankare pasi ta merr pagesën e vet. Pas marrjes së pagesës dhe varësisht nga anulimi i debitit sipas nenit 5.3 banka iniciatore detyrohet ndaj iniciatorit në shumën e urdhërpagesës së iniciatorit dhe çfarëdo kredie të përkohshme që i është dhënë iniciatorit është përfundimtare. Para se kredia e tillë të bëhet përfundimtare, nga banka iniciatore nuk kërkohet që t'i lëshojë mjetet financiare për iniciatorin, përveç rastit kur janë marrë vesh ndryshe dhe çfarëdo lëshimi i fondeve para kryerjes së transferit të kredisë është i përkohshëm derisa ai nuk kryhet.

### Neni 14 Shlyerja e borxhi të paguar me transferin e debitit

Kur një transfer i debitit bëhet për pagesën e një borxhi të cilin një marrës ia ka iniciatorit në shumën e atij borxhi, borxhi konsiderohet i shlyer kur banka iniciatore hyn në borxh ndaj iniciatorit në shumën e urdhërpagesës së iniciatorit pas kryerjes së transaksionit të pagesës.

## **Kapitla 5** **Përgjegjësia, dëmet dhe kompenzimi**

### Neni 15 Përgjegjësia për pagesat e autorizuara ose të vërtetuara dhe anulimi i urdhëresave

Personi fizik ose juridik i identifikuar si dërgues është përgjegjës për udhëpagesën dhe anulimin e urdhërit që është bërë në emër të autorizimit të tij, ose që është vërtetuar nga banka marrëse, përveç rastit kur dërguesi dëshmon se urdhërpagesa ose anulimi është bërë pa autorizimin e tij ose është shkelur procedura e vërtetimit.

Neni 16  
Përgjegjësia e dërguesit

16.1 Kur kryhet një transfer i kredisë, dërguesi nuk e ngarkon bankën marrëse dhe e kompenzon bankën e tillë për çfarëdo humbje që pëson ajo në shumën e urdhërpagesës dhe me këtë i mbulon shpenzimet e arsyeshme si pagesat dhe përqindjen e kamatës.

16.2 Në një transfer debiti, secili dërgues i garanton bankës së tij marrëse se urdhërpagesa e tij është e autorizuar dhe se është në përputhje me autorizimin e iniciatorit dhe marrësit dhe se secila urdhërpagesë është efektive dhe e vlefshme .

Neni 17  
Lirimi i iniciatorit nga përgjegjësia në një transfer të kredisë

17.1 Kur nuk kryhet një transfer i kredisë, iniciatori nuk ka përgjegjësi ndaj bankës iniciatore dhe ka të drejtë që llogaria e tij bankare të rikreditohet për shumën e borxhit të debituar për mbulimin e asaj urdhërpagese. Iniciatori më tej ka të drejtë t'i marrë nga banka iniciatore të gjitha shpenzimet e arsyeshme, pagesat dhe kamatën.

17.2 Banka iniciatore dhe çdo bankë ndërmjetësuese që i ka kryer udhëzimet e dërguesit të saj nuk ka përgjegjësi ndaj bankës marrëse dhe ka të drejtë përkatëse nga banka marrëse si dhe të drejtën e kompenzimit në çfarëdo kamate të arsyeshme në rast se transferi i kredisë nuk është kryer.

17.3 Të drejtat sipas këtij neni (17) vlejné pavarësisht nga ekzistimi ose mosekzistimi i gabimi të cilido pjesëmarrës në transaksionin e pagesës.

Neni 18  
Përgjegjësia e bankës marrëse

18.1 Banka marrëse e cila:

- (a) nuk e ka njoftuar dërguesin e saj për refuzimin e urdhërpagesës së vet ose
- (b) ka qenë tejet e pakujdesshme në zbatimin ose moszbatimin e urdhërpagesës

është përgjegjëse ndaj iniciatorit, pa marrë parasysh se a ka qenë iniciatori vetë dërgues apo jo, me kusht që iniciatori të mos ketë qenë i pakujdesshëm për shpenzimet e arsyeshme, për pagesat, kamatat dhe dëmet e tjera plotësuese reale të cilat nuk e kalojnë shumën kryesore të urdhërpagesës së iniciatorit. Aty ku mund të zbatohet, dërguesi ka të drejtë sipas nenit 17 në kthimin e parave deri në kufirin e shumës së urdhërpagesës.

18.2 Iniciatori e gëzon të drejtën e kthimit të parave, si nga banka iniciatore e cila mund të ketë qenë tejet e pakujdesshme, po ashtu edhe nga çdo bankë tjetër që nuk ka pasur kujdes. Nga këto banka, përgjegjësinë e mban banka me më shumë gabime, varësisht nga shkalla e gabimeve të tyre përkatëse.

Neni 19Kryerja e gabuar e transferit të kredisë

Transferi i kredisë është kryer, por në përputhje me udhëzimin e dhënë në udhërpagesën e iniciatorit vlej në rregullat vijuese:

19.1 Kur shuma e paguar për marrësin e tejkalon shumën e urdhërpagesës së dërguesit, secili dërgues është përgjegjës për shumën e urdhërpagesës së vet. Shumën e paguar tepër marrësi ia kthen bankës që ka gabuar sipas dispozitave të ligjit të zbatueshëm në vendin ku ndodhet selia e bankës destinuese.

19.2 Kur shuma që i paguhet marrësit është më e vogël se shuma e urdhërpagesës së iniciatorit, konsiderohet se transferi i kredisë është kryer në shumën që i është paguar marrësit, me ç'rast banka që ka gabuar e paguan dallimin dhe, nëse zbatohet, ka të drejtën e kompenzimit nga iniciatori.

19.3 Kur pagesa i bëhet marrësit, ndryshe nga mënyra e identifikuar në udhërpagesën e iniciatorit, konsiderohet se nuk është kryer transferi i kredisë. Shumën e paguar tepër marrësi ia kthen bankës që ka gabuar në përputhje me dispozitat e ligjit të zbatueshëm në vendin ku ndodhet selia e bankës destinuese.

Neni 20Kryerja e gabuar e transferit të debitit

20.1 Kur shuma e paguar nga marrësi e tejkalon shumën e urdhërpagesës së iniciatorit, marrësi ka të drejtë që në llogarinë e tij t'i kthehet ai dallim. Banka destinuese dhe çdo bankë marrëse është përgjegjëse ndaj dërguesit të saj vetëm për shumën e urdhërpagesës së pagesës së iniciatorit.

20.2 Kur shuma e paguar nga marrësi është më e vogël se shuma e urdhërpagesës së iniciatorit, marrësi është përgjegjës ndaj bankës destinuese, ndërsa banka destinuese dhe çdo bankë marrëse është përgjegjëse ndaj dërguesit për dallimin.

20.3 Kur pagesa është bërë nga marrësi, ndryshe nga mënyra e identifikuar në urdhërpagesën e iniciatorit, konsiderohet se transferi i debitit nuk është kryer.

**Kaptina 6****Përpunuesit e palës së tretë**Neni 21Shfrytëzimi i përpunuesve të palës së tretë

Gjatë kryerjes të çfarëdo pjese të transaksionit të pagesës, banka mund të shfrytëzojë përpunuesin e palës së tretë. Sipas autorizimit të bankës, përpunuesi i palës së tretë mund të veprojë në emër të bankës së tillë si:

- (a) shërbim i komunikimit;
- (b) shërbim ndërbankare i likuidimit, që më tej mund t'i përcjellë informatat e shlyerjeve ndërbankare në BPK;

- (c) shërbim menagjimi ose veprimi i llogarive bankare të klientëve dhe
- (ç) shërbim dërgues ose marrës për urdhërpagesat e dërguara apo të pranuar nga banka, të cilat klientët e bankës mund t'i përdorin drejtpërdrejt për dërgimin dhe pranimin e urdhërpagesave.

Neni 22  
Kushtet

22.1 Përpunuesi i palës së tretë është një person juridik i autorizuar, i cili mbikëqyret dhe mbahet nën kontroll nga BPK për të vepruar si përpunues i palës së tretë.

22.2 Banka mund të veprojë si përpunues i palës së tretë në emër të një bankë tjetër.

Neni 23  
Përgjegjësia e bankës për përpunuesit e palës së tretë

Përveç ndaj vetes së saj dhe përpunuesit të palës së tretë, banka mban përgjegjësi dhe është e përgjegjshme për të gjitha veprimet dhe gabimet e përpunuesit të palës së tretë, i cili me autorizimin e saj vepron në emër të bankës.

Neni 24  
Transferi dhe marrja e urdhërpagesave nga përpunuesit e palës së tretë

24.1 Përpunuesi i palës së tretë e refuzon urdhërpagesën që i është dërguar drejtpërdrejt atij nga një klient i bankës, përveç nëse :

- (a) banka e ka autorizuar klientin e saj që të dërgojë një urdhërpagesë të tillë dhe
- (b) në rastin kur të transferit të kredisë
  - (i) përpunuesi i palës së tretë vepron në emër të bankës si shërbim menaxhimi apo veprimi për llogarinë bankare të klientit dhe ekziston mbulesë adekuate në llogarinë bankare të bankës së klientit ose
  - (ii) përpunuesi i palës së tretë ka marrë autorizim për të dërguar një urdhërpagesë nga banka.

Urdhërpagesa e klientit të bankës që vepron sipas urdhërit të përpunuesit të palës së tretë konsiderohet të jetë një udhëzim nga një klient i bankës për bankën e vet dhe një udhëzim i asaj banke për përpunuesin e palës së tretë që është autorizuar për transferin e urdhërpagesës në bankën destinuese.

24.2 Kur banka ka autorizuar një përpunues të palës së tretë, i cili vepron si shërbim marrës i urdhërpagesave të dërguara në bankë, urdhërpagesa e pranuar nga përpunuesi i palës së tretë konsiderohet se është pranuar nga banka e cila vepron si bankë marrëse.

## **Kapitina 7**

### **Dispozitat speciale lidhur me llogaritë bankare në transaksionet e pagesave**

#### Neni 25 Tërheqjet dhe pagesat

25.1 Varësiht nga kushtet e marrëveshjes, bilanci i kredisë i cili ka mbulesë adekuatë në një llogari mund të tërhiqet nga klienti ose të paguhet nga banka në përputhje me udhëpagesën.

25.2 Neni 25.21 nuk zbatohet në rastin kur bilanci i kredisë në një llogari bankare i është nënshtruar sekuestrimit, konfiskimit apo ndonjë procesi të ngjashëm kreditor; kur llogaria bankare është mbyllur, është pezulluar ose është ngrirë dhe kur në kryerjen urdhërpagesave banka ka shkelur ligjin në fuqi.

#### Neni 26 Pasqyra e llogarisë bankare

26.1 Përveç për llogaritë e librezave të kursimit, banka u ofron klientëve të saj, në intervale kohore që nuk e kalojnë një muaj kalendarik, një pasqyrë të llogarisë, në të cilën shënohet çdo kredi dhe debit i regjistruar në llogari që nga dhënia e pasqyrës së fundit si dhe për bilancin përfundimtar të llogarisë bankare.

26.2 Për llogarinë e kursimit banka vazhdimisht e lehtëson azhurnimin e gjendjes së librezës së kursimit. Në azhurnimet e tilla regjistrohet çdo kredi apo debit i shënuar në llogarinë bankare që nga data e azhurnimi të parë si dhe bilanci përfundimtar i llogarisë. Nga klienti kërkohet që rregullisht ta azhurnojë gjendjen e librezës së kursimit.

26.3 Klienti duhet të tregojë kujdes të përditshëm sa i përket kontrollimit të pasqyrave periodike dhe azhurnimin e librezës së kursimit dhe ta njoftojë bankën sa më parë, nga momenti kur klienti kupton për çfarëdo mospërputhje të debitit apo kredisë së kontestuar. Banka i ndihmon klientit në ekzaminimin e mospërputhjeve të tilla në debitet ose borxhet e kontestuara, duke i ofruar informatat përkatëse që ajo i ka në dispozicion dhe, nëse është e zbatueshme, i bënë të gjitha përmirësimet dhe korrigjimet në llogarinë bankare ose në librezën e kursimit.

#### Neni 27 Sekreti

Banka ruan sekretin afarist dhe nuk i zbulon të dhënat e llogarive bankare të asnjë klienti, përveç rastit kur një gjë e tillë kërkohet me një urdhëresë gjyqësore, sipas ligjit në fuqi apo sipas autorizimit të shprehur të klientit.

#### Neni 28 Ndryshimi

Banka nuk i ndryshon në mënyrë të njëanëshme kushtet e marrëveshjes, përveç rastit kur për këtë ndryshim e njofton klientin me shkrim së paku 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes në fuqi të

këtij ndryshimi me të cilin klienti pajtohet. Ndryshimi i cili shkel këtë dispozitë nuk është i vlefshëm.

Neni 29  
Ndryshimet

Të drejtat dhe detyrimet e bankës dhe të klientit të saj nuk mund të ndryshohen me marrëveshje, po qe se në këtë Rregullore nuk parashihet ndryshe. Përjashtim bën rasti kur me marrëveshje klienti i bankës fiton më shumë të drejta.

Neni 30  
Trajtimi i ndershëm dhe mirëbesimi

30. 1 Për ta detyruar klientin, marrëveshja duhet të jetë e ndershme dhe të drejtat e obligimet e bankës dhe të klientit duhet të përcaktohen me një gjuhë të qartë e të thjeshtë. Gjuha juridike dhe specifike duhet të pëdoret vetëm kur kjo është e domosdoshme.

30. 2 Banka dhe klienti i saj detyrohen t'i përmbushin detyrimet e tyre në përputhje me marrëveshjen dhe me mirëbesim.

**Kaptina 8**  
**Të ndryshme**

Neni 31  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 8 tetor 2001.

Hans Haekkerup,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm